



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 15, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 03.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

- OBJEKT:** Për lirimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 15, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.
- BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partia politike,

V Ë R E N

Me shkresën nr.4567 prot., datë 23.05.2019, anëtarja e KZAZ nr.15, zj.Artenisa Bibaj, emëruar kryesisht me vendimin Nr.141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

KQZ bazuar në nenin 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra anëtares e emëruar kryesisht të KZAZ nr.15 dhe plotëson vakancën duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019.

KQZ, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV" do të përzgjedhë përmes procedurës së shortit për plotësimin e vakancës së krijuar.



Nr. 794 i Vendimit Data 03.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 15, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr.15, zj.Artenisa Bibaj.
2. Të emërojë kryesisht anëtarin e KZAZ-së nr.15, z. Gersi Sula.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 794 i Vendimit Data 03.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërim kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 15, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.